




Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.1.2024, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës, me nr. prot. 02/5421/25, i datës 18.03.2025 dhe merret vendimi për **caktimin** e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në parcelën kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02240-81 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2000m² (dy mijë metra katror), Zona Kadastrale Rahovec, e evidentuar në emër të Komunës së Rahovecit, parcela me nr.02240-81 do të ndahet dhe formohet parcela me numër të ri. Parcela në fjalë do ti jepet në shfrytëzim drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.
3. Parcela e cekur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.1.2024, ka destinim: 3. Prodhim tretësor/ 31. Shërbim tregtar/ 311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01 Nr. 29/25 i datës 28.03.2025.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284

për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivi.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.47/25
Me datë:29.04.2025

Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit

